



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.24

Prishtinë, më 16.09.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Srdjan Popović, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyqi, Teuta Haxhiu dhe Mufera Sinik.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqesues të OSBE-së, të KDI –së dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 29.07.2015;
3. Diskutim lidhur me planin e punës së Komisionit për sesionin vjeshtor;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 29.07.2015

Procesverbali i mbledhjes së dates 29.07.2015 u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me planin e punës së Komisionit për sesionin vjeshtor,

Nait Hasani, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se në kuadër të përmbushjes së planit të punës së Komisionit në sesionin pranveror kemi bërë mjaft punë në aspektin e shqyrtimit të projektligjeve, mbajtjes së dëgjimeve publike dhe vizitave të realizuara në teren. Ndërsa sa i përket pjesës së planifikuar për monitorim të ligjeve kemi ngecje me përjashtim të monitorimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në të cilin është punuar më shumë dhe lidhur me këtë kërkoj përkushtim më të madh në sesionin vjeshtor.

Ismajl Kurteshi, njoftoi anëtarët e Komisionit me aktivitetet e ndërrmarra sipas planit të veprimit lidhur me monitorimin e Ligjit për Arsimin Parauniversitar. Sa i përket kësaj ngriti çështjen e analizës së përputhshmerisë së Ligjit për Arsimin Parauniversitar me Udhëzimet Administrative të nxjerra nga MASHT. Ndërsa sa i përket realizimit të planit të punës të Komisionit tha se vonesat e procedimit të projektligjeve nga Qeveria kanë ndikuar në mos përmbushjen e planit të punës.

Bekim Haxhiu, tha se si Komision kemi bërë mjaft punë ndërsa Ministrinë nuk kanë qenë aktive në procedimin e projektligjeve sipas afateve kohore të planifikuara. Me këtë rast përmendi Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e dhunës në sport, Projektligjin për sponsorizime dhe donacione dhe projektligjin për shfrytëzimin dhe menaxhimin e objekteve sportive. Sa i përket vizitave të Komisionit, vlerëson se vizita e realizuar në Berlin ka qenë shumë e sukseshshme dhe përvojat e marra atje do shërbejnë për përmirësimin e cilësisë në arsim. Sa i përket fushës së arsimit përseri ngriti problemin e peshës së çantave të ngarkuara të nxënësve, e cila po rezulton me pasoja për shëndetin e nxënësve me deformimet e shtyllës kurrizore të cilën e konsideron si shqetësim dhe lidhur me këtë kërkoj që për mbledhjen e radhës Komisioni ta fton ministrin e MASHT që të raportoi.

Teuta Haxhiu, theksoi se agenda e Komisionit në sesionin pranveror ka qenë mjaft e ngarkuar dhe e frytshme. Sa i përket strategjisë legjislative të Qeverisë, dhe vonesën e procedimit të projektligjit për Arsimin e Lartë e konsideron të panevojshme, si Komision kërkoj që të përshpejtohen punët rreth monitorimit të ligjeve.

Ajo ngriti problematiken e 305 mësimdhënësve të cilët kanë prëfudnuar studimet në kolegjet private të cilët në kundërshtim me ligjin aktualisht janë së sistemin arsimor. Ngriti shqetësimin lidhur me vendimin e MASHT nr.231/01B datë 04.08.2015 me të cilin të diplomuarit në kolegjet private konsiderohen të barabartë me të diplomuarit në programet e njëjta nga universitetet publike. Lidhur me këtë çështje kërkon që të ftohet ministri i MASHT të raportoi në Komision.

Shpejtim Bulliqi, tha se kemi bërë një punë të qmueshme por evidentohen edhe ngecje si rezultat i vonesave të ministrive për procedimin e çështjeve në Kuvend. Sa i përket projektligjit të Maturës Shtetërore tha se kemi punuar mjaft dhe duhet të finalizohet puna.

Shukrije Bytyqi, tha se puna e bërë në Komision është për tu vlerësuar dhe kërkon që në aspektin e monitorimit të bëhet një angazhim më i madh. Kërkoi që në njërin nga mbledhjet e radhës të ftohet ministri i Diasporës në mënyrë që të njoftoi Komisionin lidhur me të arriturat dhe sfidat e diasporës.

Salih Morina, tha se si Komision në sesionin pranveror jemi marrë më shumë me çështjet e fushës së arsimit, kemi realizuar shumë vizita në teren ndërsa në aspektin e monitorimit të ligjeve duhet të angazhohemi më shumë. Kërkoi që Komisioni të ftoj ministrin e MASHT në mënyrë që diskutohet çështja e regjistrimit të studentëve në kolegjet private të arsimit të lartë në mënyrë që të caktohet një afat kohor për regjistrim.

Mufera Sinik, ngriti çështjen e nostrifikimit të diplomave të marra para vitit 1999 në gjuhën turke dhe për këtë çështje mendon se ministri i MASHT duhet të sqaroi në mbledhjen e radhës.

Nait Hasani, tha se duke pasur parasysh se kemi një agjendë të ngarkaur në sesionin vjeshtor, për javën që vjen propozoi këtë agjendë:

- **E hënë, 21.09.2015** – vizitë në Komunën e Malishevës, Rahovecit dhe Suharekës me qëllim të njohjes për së afërmi me sfidat dhe të arriturat në fushën e arsimit dhe të kulturës,
- **E martë, 22.09.2015** - të ftohet ministri i Arsimit z.Arsim Bajrami të raportoj për këto çështje: fillimi i vitit shkollor 2015/2016, Vendimi i ministrisë nr. 231/01B të datës 4.8.2015, gjendja aktuale në Arsimin e Lartë publik dhe privat, procesi i nostrifikimit të diplomave dhe çështja e procesit të akreditimit, problematika rreth peshës së çantave shkollore dhe veprimet e ndërmarra nga MASHT për ngritjen e cilësisë në arsim.
- **E mërkurë, 23.09.2015** – të organizohet dëgjim publik lidhur me projektligjin për Kinematografinë.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me agjendën e propozuar.

4. Të ndryshme

Nait Hasani, njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me disa shkresa që i janë adresuar Komisionit. Shkresa nga Fakulteti i Arteve dërguar Komisionit për mos Akreditim nga ana e Agjencionit për Akreditim.

Njoftimi për Komisionin lidhur me fillimin e punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe zgjedhjen e kryetarit të Këshillit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani